

Bazuar në nenin 3 dhe 4, nenin 39 paragrafi 1 dhe nenin 40 paragrafi 1 të Ligjit mbi pronën shtetërore ("Fleta zyrtare e Malit të Zi nr. 21/09 dhe 40/11"), Rregullorja për shitjen dhe dhënien me qira të sendeve në pronësinë shtetërore ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 44/10), Vendimet për dhënien me qira të truallit përmes mbledhjes së ofertave për instalimin e objekteve të përkohshme ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi - Dispozitat komunale", nr. 09/22), Vendimet për plotësimin e Vendimit mbi dhënien me qira të truallit përmes mbledhjes së ofertave për instalimin e objekteve të përkohshme ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi - Dispozitat komunale", nr. 24/22), Vendimi për konfirmimin e vendimit mbi dhënien me qira të truallit përmes mbledhjes së ofertave për instalimin e Objekteve të përkohshme ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi - Dispozitat Komunale" Nr. 015/22), Neni 28 dhe 29 të Vendimit mbi dhënien e pëlqimit komunës së Tuzit për zbatimin e procedurës për dhënien me qira të truallit në territorin e saj me qëllim të vendosjes së objekteve të përkohshme ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale", nr. 20/20.), Sekretariati për Pronë shpall

THIRRJE PUBLIKE

për dhënien me qira të truallit për instalimin e objekteve të përkohshme të karakterit montues përmes mbledhjes së ofertave

Lënda e thirrjes publike është dhënia me qira e truallit për instalimin e objekteve të përkohshme me karakter montues, me mbledhjen e ofertave, në vendndodhjet e mëposhtme:

Nr. i vendndodhjes	Lloji i objektit sipas mënyrës së ngjitjes në truall	Parcela kadastrale	Lloji i objektit sipas qëllimit	Sipërfaqja	Çmimi minimal mujor i qirasë së truallit pa TVSH
1.4	Objekt i përkohshëm i montueshëm dhe i çmontueshëm	2242 KK Tuz	Bar i hapur me tarracë	30.00 m ²	37,5 eur
1.5	Objekt i përkohshëm i montueshëm dhe i çmontueshëm	2242 KK Tuz	Bar i hapur me tarracë	30.00 m ²	37,5 eur
1.6	Objekt i përkohshëm i montueshëm dhe i çmontueshëm	2242 KK Tuz	Bar i hapur me tarracë	25.00 m ²	31,25 eur
1.7	Objekt i përkohshëm i montueshëm dhe i çmontueshëm	2242 KK Tuz	Bar i hapur me tarracë	25.00 m ²	31,25 eur
1.8	Objekt i përkohshëm i montueshëm dhe i çmontueshëm	2242 KK Tuz	Bar i hapur me tarracë	25.00 m ²	31,25 eur

Kushtet e përgjithshme të thirrjes publike

Trualli jepet me qira për një periudhë prej një viti, duke filluar nga dita e lidhjes së kontratës së qirasë. Nëse gjatë afatit të qirasë, ndryshohet qëllimi i paraparë i truallit, marrëveshja e qirasë do të ndërpritet dhe qiramarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë kompensim për mjetet e investuara.

Të dhënat për vendndodhjen, llojet, tipin, sipërfaqen dhe pamjen e objektit të përkohshëm përcaktohen me Programin e objekteve të përkohshme të komunës së Tuzit 2020-2025 ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat Komunale", numër 20/20) dhe Vendimi mbi miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në programin e objekteve të përkohshme për territorin e komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale", numër 46/21).

Thirrja publike do të vendoset në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e komunës së Tuzit tuzi.org.me dhe do të publikohet në gazetën ditore "Pobjeda".

Mënyra, vendi dhe koha e dorëzimit të aplikimeve

Aplikimet dorëzohen në zarf të mbyllur (në mënyrë që me hapjen e ofertës të konstatohet me siguri se hapet për herë të parë), me shënimin "**aplikim për mbledhjen e ofertave për vendndodhjen (numri i vendndodhjes) - Komisionit për zbatimin e procedurës së mbledhjes së ofertave - mos të hapet para seancës zyrtare të Komisionit**", drejtpërdrejt në arkivin e komunës së Tuzit ose me postë në adresën: Ulica Tuzi nr.1, nr. 44, 81206 Tuzi.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikime është prej datës 31 maj 2023 deri më 06.06.2023 deri në ora 15.00.

Aplikimet e dorëzuara pas afatit të caktuar, si dhe aplikimet që nuk janë dorëzuar në zarf të mbyllur dhe që nuk përmbajnë të gjitha të dhënat dhe provat e përcaktuara me thirrje, nuk do të merren parasysht dhe do t'i kthehen ofertuesit.

Aplikantët nga paragrafi paraparak nuk do të mund të regjistrohen pranë Komisionit.

Formulari i aplikimit mund të merret nga arkivi/nëpunësit e komunës së Tuzit.

Aplikimi dhe shpenzimet - detyrimet proceduriale

Aplikimi me shkrim duhet të përmbajë:

- **për personat juridik:** emri dhe selia e personit juridik, vërtetim nga CRPS (jo më i vjetër se tre muaj), për kompanitë vendase, gjegjësisht dëshmi e regjistrimit të lëshuar nga organi kompetent në të cilin personi juridik është i regjistruar për personat e tjerë juridik, ndërsa për personat e huaj vërtetimin e regjistrimit të organit kompetent nga shtetit amë i ofertuesit të huaj (origjinalin ose kopje e vërtetuar e vendimit), emri dhe mbiemri i drejtorit dhe nënshkrimi i tij, autorizimi - prokura për të marrë pjesë në tenderin publik, numrin e xhiro llogarisë për rimbursimin e depozitës, numrin e telefonit, e-mailin dhe vulën.
- **për personat fizikë:** mbiemri dhe emri, numri unik amëz, numri i kartës së identitetit ose dokumenti i udhëtimit (pasaporta), adresa, numri i xhiro llogarisë për rimbursim të depozitës dhe numër telefoni.
- përcaktimi (numri) i vendndodhjes së përkohshme të cilës i referohet oferta.
- dëshmi të shpenzimeve të paguara për kryerjen e procedurës së arkëtimit të tenderit në vlerë prej 20,00€ me shënimin "pjesëmarrje në procedurën e mbledhjes së ofertave" në llogarinë xhiro-llogari të komunës së Tuzit me numër 530-3376228-69 pranë bankës NLB.
- Dëshmi për pagesën e depozitës në shumën prej 3 (tre) çmime minimale mujore të qirasë pa TVSH për vendndodhjen ku i referohet oferta në xhiro-llogarinë e komunës së Tuzit me numër 530-000003376229-66 pranë bankës NLB.
- Vërtetim nga Sekretariati për Financa se nuk ka detyrime tatimore të papaguara ndaj komunës së Tuzit.
- Shuma mujore e ofruar e qirasë për një vendndodhje të caktuar, e shprehur në euro.

Nëse ofertuesi është person juridik i huaj, dokumentacioni i lëshuar nga organi kompetent i shtetit në të cilin është themeluar shoqëria duhet të dorëzohet, i përkthyer në gjuhën malazeze, i vërtetuar nga përkthyesi gjyqësor.

Shënim: Nëse një person dorëzon oferta të shumta për të njëjtin vend, oferta që përmban çmimin më të lartë të ofruar do të merret parasysh.

Shpenzimet e përdorura për kryerjen e procedurës së mbledhjes së ofertave nuk janë të rimbursueshme.

Depozita e paguar do t'u kthehet ofertuesve të pazgjedhur brenda 10 (dhjetë) ditëve pas përfundimit të vendimit për zgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm, dhe për ofertuesit e përzgjedhur kjo shumë do të përfshihet në shumën e qirasë me rastin e lidhjes së kontratës së qirasë.

Vendi dhe koha e hapjes së ofertave

Ofertat do të hapen më 8 qershor 2023. duke filluar nga ora 10:00 në ndërtesën e komunës së Tuzit. Aplikantët për pjesëmarrje në procedurën e mbledhjes së ofertave duhet të regjistrohen në Komisionin gjysmë ore para fillimit të procedurës.

Prania fizike e palëve të interesuara është e detyrueshme për pjesëmarrje në procedurën e hapjes së ofertave, në të kundërtën ofertat me shkrim pa prani fizike nuk do të merren parasysh.

Përzgjedhja e ofertuesit më të favorshëm

Komisioni sjell vendim me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Renditja dhe vlerësimi i ofertave bazohet në kriteret e mëposhtme: shumën e ofruar të qirasë.

Ofertuesi i renditur i pari do të konsiderohet pjesëmarrësi që ofron shumën më të lartë të qirasë.

Nëse oferta është e pavlefshme ose nuk pranohet, depozita do t'i kthehet ofertuesit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e procedurës.

Në rast se ofertuesi më i favorshëm heq dorë nga qiraja pas hapjes së ofertës, ai humbet të drejtën e rimbursimit të depozitës dhe ofertuesi tjetër më i favorshëm do të ftohet për të lidhur kontratën e qirasë.

Nëse konstatohet se dy ose më shumë ofertues kanë dorëzuar oferta me të njëjtën shumë të qirasë, ofertuesi, oferta e të cilit ka mbërritur i pari në kohë do të konsiderohet ofertuesi më i favorshëm.

Vendimi për përzgjedhjen e ofertuesve më të favorshëm merret nga Komisioni për zbatimin e procedurës së mbledhjes së ofertave brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e hapjes së ofertave. Ai do të publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e komunës së Tuzit www.tuzi.org.me brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e sjelljes së vendimit. Njoftimet e veçanta për rezultatin e procedurës do t'u dërgohen nga Komisioni për zbatimin e procedurës së mbledhjes së ofertave të gjithë pjesëmarrësve që kanë dorëzuar oferta korrekte dhe të rregullta brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e hapjes së ofertave.

Pjesëmarrësit në procedurë kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin për përzgjedhjen e ofertuesve më të favorshëm brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit, përkatësisht nga dita e publikimit të vendimit, nëse njoftimi nuk kërkohet të dorëzohet në përputhje me përcaktimet e kësaj thirrjeje publike.

Komisioni do të zbatojë dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative në procedurën e ankesës.

Vendimi i Komisionit për ankesën është përfundimtar. Pas përfundimit të vendimit, Komisioni i dërgon një njoftim përfundimtar ofertuesit më të favorshëm, nga data e cila fillon afati për lidhjen e kontratës.

Lidhja e kontratës

Sekretariati për Pronë do të lidhë kontratë qiraje me ofertuesin e përzgjedhur brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të njoftimit për përfundimin e vendimit për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme.

Shuma totale e qirasë për të gjithë periudhën e qirasë paguhet në momentin e lidhjes së kontratës së qirasë së truallit.

Informacion më të detajuar rreth procedurës së thirrjes publike mund të merrni çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në 16:00 në tel. 020/875-167, pranë Komisionit për zbatimin e procedurës së mbledhjes së ofertave.

Numër: 09-019/23- 3730/11
Tuz, më 30.05.2023

**KOMUNA TUZIT
SEKRETARIATI PËR PRONË
Me autorizim të SEKRETARES,
Ndihmës Sekretari**

Agim Sinishtaj

